



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Nr. 10760 prot.

Tiranë, më 27. 11. 2020

URDHËR

Nr. 185, datë 27. 11. 2020

Për

“Marrjen e masave administrative deri në përfundim të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni Covid -19”.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ATP”; Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar, Urdhër nr. 80, datë 17.11.2020 i Departamentit të Administratës Publike për “*Miratimin e Rregullores Tip* për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid -19,

URDHËROJ

1. Marrjen e masave administrative dhe miratimin e grafikut të punës deri në përfundim të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni Covid -19, bazuar në “Rregulloren Tip” të miratuar nga Departamenti i Administratës Publike si më poshtë vijon:
 - a. Të gjithë punonjësit e Agjencisë së Trajtimit të pronave, do të vijojnë të punojnë pranë institucionit dhe/ose në distancë, sipas grafikëve të përcaktuar nga secila Drejtori. Punonjësit që kanë përfunduar kohën e punës në institucion sipas orarit të përcaktuar nga eprori, do të kryejnë deyrat nëpërmjet telepunes për pjesën tjetër të orarit.
 - b. Ofrimi i shërbimeve në sportelet e marrëdhënieve me publikun për shërbime dhe aplikime do të funksionojë sipas Rregullores së miratuar me nr. 5969/5 prot. dt.17.11.2020 nga Departamenti i Administratës Publike deri në përfundim të gjendjes së epidemisë dhe nëpërmjet shërbimeve online dhe përmes postës zyrtare.

- c. Punonjësit që do të punojnë në distancë, do t'iu delegohen shkresat nëpërmjet e-mailit zyrtarë nga eprorët përkatës. Nëpunësi që i është deleguar praktika do të shqyrtojë dhe hartojë përgjigjen dhe pas marrjes së miratimit nga eprori përkatës e dërgon atë tek nëpunësi që është ngarkuar të jetë prezent në institucioni sipas grafikut përkatës, për procesim të mëtejshëm.
- d. Për shkak të numrit të reduktuar të punonjësve në institucione, delegimi i shkresave do të bëhet nëpërmjet sistemeve elektronike e – albania /SQDNE/e-aktet/e-mail zyrtarë dhe të njëjtën mënyrë do të procedohet dhe për kthimin e përgjigjeve, me përjashtim të rasteve të drejtorive specifike. Afatet për procesimin e shkresave janë të njëjta, si zakonisht dhe nuk do të tolerohet asnjë vonesë në kthimin e përgjigjeve.
- e. Punonjësit që do të paraqiten në punë sipas grafikut të përcaktuar, duhet të respektojnë të gjitha udhëzimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për mbrojtjen personale dhe marrjen e masave mbrojtëse për mospërhapjen e virusit (të ruhet distanca 2 m nga njëri tjetri/përdorimi i maskave/ dorezave dhe dizinfektantëve).
- f. Urdhëri nr.113, datë 29.05.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm shfuqizohet.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PERGJITHSHEM
Jonida Baci
